

Vendim nr. 320 datë 27.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 27.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 29 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: ELONA JONUZAJ, INES JONUZAJ, AMANTIA JONUZAJ, përfaqësuar nga avokate Hanëme Bakia, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 667 akti, datë 25.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 371, datë 14.05.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-3183, datë 19.07.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, pika 2, 41, pika 1, 42, pikat 1 dhe 2, 124, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkueset Elona Jonuzaj dhe fëmijët e saj, Ines Jonuzaj dhe Amantia Jonuzaj, janë trashëgimtare ligjore të të ndjerit E.J., respektivisht bashkëshorti dhe babai i kërkueseve, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2015.

2. Në vitin 1998 prindërit e trashëgimlënësit të kërkueseve, konkretisht shtetasit M.J. dhe N.J., përmes dy kontratave të shitblerjes (nr. 2307/802, datë 09.05.1998 dhe nr. 3126/1095, datë 14.07.1998) kanë fituar pronësinë mbi një truall me sipërfaqe 153,8 m², të ndodhur në Tiranë, mbi të cilin, në vijim, sipas lejes së ndërtimit të vitit 2000, është ndërtuar një objekt 4-katësh, ku subjekt ndërtues ka qenë i biri E.J., trashëgimlënësi i kërkueseve. Pas përfundimit të ndërtimit, pasuria ndërtesë dhe trualli i saj janë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi të shtetasve/bashkëshortëve M.J. dhe N.J.

3. Në vitin 2014 ka ndërruar jetë bashkëpronari M.J. dhe me dëshminë noteriale të trashëgimisë ligjore të datës 07.01.2015, si trashëgimtarë ligjorë të tij janë përcaktuar bashkëshortja N.J. dhe dy djemtë E.J. (trashëgimlënësi i kërkueseve) dhe E.J., në bashkëpronësi të të cilëve në vijim është regjistruar pasuria ndërtesë dhe truall, konkretisht N.J. për 4/6-at pjesë, ndërsa E.J. dhe E.J. secili për 1/6-ën pjesë të pasurisë. Pas vdekjes së trashëgimlënësit të kërkueseve, pasuria është regjistruar në bashkëpronësi të N.J. me 15/24-at pjesë, të kërkueseve secila me 1/24-ën pjesë, E.J me 3/24-at pjesë dhe L.Gj. me 3/24-at pjesë.

4. Lidhur me rrethin e trashëgimtarëve të bashkëpronarit M.J. dhe bashkëpronësinë mbi pasurinë ndërtesë dhe truall ka lindur një mosmarrëveshje mes së bijës së tij L.Gj., nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, trashëgimtarëve të përcaktuar në dëshminë noteriale të trashëgimisë ligjore të datës 07.01.2015 dhe bashkëpronarëve të pasurisë së regjistruar në vijim, konkretisht shtetasve N.J., E.J. dhe kërkueseve. Mosmarrëveshja është zgjidhur me vendimin nr. 6678, datë 27.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*vendimi nr. 6678/2016*), e cila ka vendosur të njohë paditësen L.Gj. si trashëgimtare ligjore të trashëgimlënësit M.J., si dhe të detyrojë të paditurit të njohin këtë shtetase si bashkëpronare në 3/24-at pjesë të pasurisë ndërtesë dhe truall. Ky vendim ka marrë formë të prerë, sepse Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 119, datë 24.01.2017, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak se kërkueset kanë hequr dorë nga ankimi. Pasuria më pas është regjistruar në bashkëpronësi edhe të shtetasve L.Gj.

5. Në vijim, kërkueset i janë drejtuar gjykatës me padi për pjesëtimin e pasurisë ndërtesë dhe truall, duke pretenduar se janë bashkëpronare të pasurisë dhe se pjesa e tyre takuese është më shumë se 1/2-ta, ndërsa përfshinte jo vetëm pjesën e trashëguar nga trashëgimlënësi i tyre E.J. (si pasuri trashëgimore nga babai i tij M.J.), por edhe kontributin e tij dhe të kërkueses Elona Jonuzaj në blerjen e truallit dhe në ndërtimin e objektit. Në proces janë thirrur si të paditur bashkëpronarët e tjerë të pasurisë objekt pjesëtimi, sikundër edhe shtetasja B.J., bashkëshortja e vëllait të trashëgimlënësit të kërkuesve.

6. Në përfundim të fazës së parë të pjesëtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 667 akti, datë 25.04.2018, ka vendosur lejimin e pjesëtimit të pasurisë ndërtesë dhe truall, duke përcaktuar rrethin e bashkëpronarëve dhe pjesët e tyre takuese mbi këtë pasuri dhe konkretisht kërkueset së bashku me 25/100-at pjesë (kërkuesja Elona me 13/100-at pjesë, kërkuesja Ines me 6/100-at pjesë dhe kërkuesja Amantia me 6/100-at pjesë), ndërsa të paditurit N.J. me 50/100-at pjesë, bashkëshortët E.J. dhe B.J. së bashku me 15/100-at pjesë (i padituri E.J. me 12,5/100-at pjesë dhe e paditura B.J. me 2,5/100-at pjesë) dhe L.Gj. me 10/100-at pjesë. Ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka pranuar se tej përmbajtjes së kontratave të shitblerjes së truallit, ku si pronarë paraqiten vetëm bashkëshortët M.J. dhe N.J., provohet se ka ekzistuar veprimi juridik i krijimit të bashkëpronësisë mes këtyre të fundit dhe dy djemve të tyre bashkë me bashkëshortet, ndërsa të gjithë ata, duke jetuar në të njëjtën gjendje familjare dhe pasur një ekonomi të përbashkët, kanë kontribuar edhe për blerjen e truallit dhe ndërtimin në vijim të objektit. Sipas saj, referuar të dhënave të ekspertimit mbi të ardhurat e palëve gjatë periudhës 1993 - 2000, pjesët takuese të bashkëpronarëve sipas kontributeve në krijimin e pasurisë janë: i ndjeri M.J. me 40/100-at pjesë; e paditura N.J. me 40/100-at pjesë; trashëgimlënësi i kërkueseve me 8/100-at pjesë; kërkuesja Elona Jonuzaj me 7/100-at pjesë; të paditurit E.J. e bashkëshortja e tij B.J. secili me 2,5/100-at pjesë. Këtyre pjesëve në vijim, ka arsyetuar ajo, për sa i përket bashkëpronarëve N.J. e E.J., iu shtohet edhe pjesa e fituar nga trashëgimia e bashkëpronarit të ndjerë M.J. (10/100), ndërsa kërkueseve, përveç kësaj, edhe pjesa takuese e fituar nga trashëgimia e trashëgimlënësit të tyre E.J. (8/100 pjesë). Ndërkohë, për bashkëpronaren L.Gj., gjykata ka arsyetuar se pjesa e saj takuese është vetëm ajo e fituar nga trashëgimia e të ndjerit M.J., pra 10/100-at. Kundër këtij vendimi, në lidhje me pjesët takuese për pasurinë objekt pjesëtimi, kanë paraqitur ankim të veçantë kërkueset. Po për pjesët takuese për pasurinë, por edhe për sa i përket rrethit të bashkëpronarëve, kanë paraqitur ankim të veçantë edhe të paditurit.

7. Pas riçeljes pjesërisht të hetimit gjyqësor, duke u administruar si provë edhe vendimi nr. 6678/2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të tij Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 371, datë 14.05.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për fazën e parë të pjesëtimit në lidhje me rrethin e bashkëpronarëve dhe pjesët e tyre takuese për pasurinë, duke përcaktuar si bashkëpronarë kërkueset me 3/24-at pjesë takuese së bashku, si dhe të paditurit N.J. me 15/24-at pjesë takuese, E.J. me 3/24-at pjesë takuese dhe L.Gj. me 3/24-at pjesë takuese, ndërkohë që ka rrëzuar padinë në lidhje me të paditurën B.J. Gjykata e apelit, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se pronësia për pasurinë truell është fituar përmes kontratave të shitblerjes vetëm nga bashkëshortët M.J. dhe N.J., kurse për ndërtesën përmes ndërtimit nga ata të saj. Sipas asaj gjykate, është i pabazuar në prova dhe ligj përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se krahas bashkëshortëve M.J. dhe N.J., bashkëpronarë të pasurisë janë edhe dy djemtë e tyre bashkë me bashkëshortet, ndërsa provat dhe faktet mbi të cilat ajo ka arritur në këtë përfundim nuk provojnë kontributin e këtyre të fundit në krijimin e pasurisë dhe fitimin edhe nga ata të pronësisë për këtë shkak. Për më tepër, arsyeton gjykata e apelit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim edhe me një vendim gjyqësor të formës së prerë (vendimin nr. 6678/2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), i cili për sa i përket pjesës takuese në bashkëpronësi fituar përmes trashëgimit nga e paditura L.Gj. përbën gjë të gjykuar në kuptim të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Sipas gjykatës së apelit, krahas të paditurës N.J. me 12/14-at pjesë takuese në origjinë, si bashkëpronare të pasurisë, për shkak të trashëgimisë së të ndjerit M.J., paraqiten edhe kërkueset secila me 1/24-ën pjesë takuese, sikundër dhe të paditurit N.J. me 3/24-at pjesë takuese (shtesë), E.J. me 3/24-at pjesë dhe L.Gj. me 3/24-at pjesë. Ndërkohë, vijon ajo gjykatë, e paditura B.J. (bashkëshortja e E.J.) nuk është trashëgimtare ligjore e të ndjerit M.J., ndaj nuk mund të jetë bashkëtrashëgimtare në këtë pasuri, duke i munguar kështu legjitimimi pasiv, shkak për të cilin padia duhet të rrëzohet. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkueset.

8. Me vendimin nr.00-2024-3183, datë 19.07.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueseve, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

9. Në datën 22.10.2024 kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 01.11.2024.

II

Pretendimet e kërkueseve

10. **Kërkueset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

10.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

10.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi dhënia e vendimeve nga gjykatat është bërë jashtë provave dhe fakteve juridike të administruara në gjykim. Qenia e gjykatave nën ndikim dhe mungesa e paanshmërisë së tyre vërtetohet nga shpejtësia rekord e gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, e cila e ka shqyrtuar çështjen jashtë radhe brenda një viti nga përfundimi i saj në shkallën e parë, në një kohë që, për shkak të kolapsit të sistemit gjyqësor, përpara saj janë në pritje për t'u gjykuar çështje të regjistruara shumë kohë përpara se ajo e kërkueseve.

10.1.2. *Së drejtës për një gjykim të drejtë*, pasi vendimet e gjykatave nuk janë bazuar në të drejtën materiale dhe procedurale, por mbi interpretime subjektive. Gjykatat kanë shkelur nenet 7, 10, 14 dhe 16 të KPC-së, të cilat përcaktojnë detyrimin e tyre që të mbështesin vendimin në faktet juridike dhe provat e administruara në gjykim, si dhe të zgjidhin çështjen në përputhje me ligjin në fuqi, ndërsa ato nuk kanë përmbushur një detyrim të tillë.

10.2. *E drejta e pronës private*, pasi me vendimet e tyre gjykatat e kanë tjetërsuar këtë të drejtë të kërkueseve në favor të të paditurve pa u bazuar në ligj dhe në aktet e dosjes gjyqësore, të cilat vërtetojnë kontributin e dhënë nga trashëgimlënësi i tyre dhe kërkuesja Elona Jonuzaj për blerjen e truallit dhe ndërtimin e objektit, kontribut ky shumë herë më i lartë se ai i të paditurve, çka i bën ato vendime abuzive dhe totalisht subjektive.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkueseve*

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik,

subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kolegji vlerëson se kërkuueset legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për të cilin kanë ngritur pretendime dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji vëren se kërkuueset kanë pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, ndër të tjera, edhe me argumentet se gjykata e shkallës së parë e ka dhënë vendimin jashtë provave dhe fakteve juridike të administruara në gjykim, dhe se gjykata e apelit e ka gjykuar çështjen me shpejtësi rekord, jashtë radhe brenda një viti nga regjistrimi i saj, në një kohë që, për shkak të kolapsit të sistemit gjyqësor, përpara asaj gjykate kanë qenë në pritje për t’u gjykuar çështje të regjistruara shumë kohë përpara se ajo e kërkueseve. Për sa i përket pretendimit për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vëren se kërkuueset një pretendim të tillë nuk e kanë ngritur në ankimin në gjykatën e apelit. Ndërsa për sa i përket pretendimit për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarëve të gjykatës së apelit, për shkak të gjykimit të çështjes jashtë radhe dhe në një kohë rekord, Kolegji vëren se kërkuueset nuk kanë ndjekur procedurën standarde për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues të asaj gjykate, ndërsa nuk rezulton dhe as pretendohet që të kenë paraqitur kërkesë për përjashtimin e tyre, mundësi kjo

e parashikuar shprehimisht në nenet 72 dhe 74 të KPC-së. Nga ana tjetër, ato nuk argumentojnë mungesën e efektivitetit të këtij mjete juridik. Për rrjedhojë, kërkueset nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, ndaj pretendimi i tyre për këto argumente nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkueseve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme për sa i përket gjykimit në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë, me argumentin se ato i kanë dhënë vendimet jashtë provave dhe fakteve juridike të administruara në gjykim, së drejtës për gjykim të drejtë dhe së drejtës së pronës, Kolegji vëren se kërkueset i janë drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve të dhëna gjatë procesit gjyqësor, të vënë në lëvizje nga ato, pasi ai është përmbyllur në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, për këto pretendime, kërkueset kanë plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës.

16. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.07.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur në datën 22.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkueset kanë pretenduar cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme në lidhje me gjyqtarët e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, me argumentin e dhënies së vendimit nga ato gjykata jashtë provave dhe fakteve juridike të administruara në gjykim. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji çmon se kërkueset nuk kanë paraqitur ndonjë fakt bindës për të argumentuar cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme, për sa i takon testit objektiv. Gjykata e apelit ka marrë në analizë provat e administruara në gjykim, por në vlerësim të tyre ka arritur në një përfundim të ndryshëm jo vetëm nga ai i gjykatës së shkallës së parë, por edhe nga sa kërkueset kanë pretenduar. Ndërkohë, në përgjigje të rekursit të kërkueseve, Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim të tyre, duke u shprehur se fakti që gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe nuk u ka njohur të drejtat e kërkuara nga ato nuk mund të konsiderohet si njëanshmëri nga ana e gjykatës, pa një shfaqje konkrete ose në dukje të paanshmërisë së pretenduar, si dhe se vendimmarrja e gjykatës nuk mund të konsiderohet si e njëanshme apo se favorizon interesat e njëres palë duke u bazuar vetëm në faktin se vendimi nuk është në favor të interesave të palës. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, në rastin konkret, në ushtrimin e funksionit të

saj si gjykatë ligji, sikundër edhe ajo është shprehur, nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave, të cilat, sipas saj, dilnin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkueseve për këtë argument nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Kërkueset kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë, duke parashtruar se vendimet e gjykatave nuk janë bazuar në të drejtën materiale dhe procedurale, por në interpretime subjektive. Sipas tyre, gjykatat kanë shkelur nenet 7, 10, 14 dhe 16 të KPC-së, të cilat përcaktojnë detyrimin e gjykatave të mbështesin vendimin në faktet juridike dhe provat e administruara në gjykim, si dhe të zgjidhin çështjen në përputhje me ligjin në fuqi, detyrim të cilin gjykatat nuk e kanë përmbushur. Po sipas kërkueseve, duke mos u bazuar në aktet e dosjes gjyqësore në lidhje me kontributin e dhënë nga trashëgimlënësi i tyre dhe kërkuesja Elona Jonuzaj për blerjen e truallit dhe ndërtimin e objektit, gjykatat u kanë cenuar edhe të drejtën e pronës private.

19. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kolegji konstaton se gjykatat e faktit, ndërsa kanë pranuar fitimin e pronësisë për një pjesë të pasurisë përmes trashëgimit nga bashkëpronari i ndjerë M.J., kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për sa i përket fitimit të pasurisë dhe rrethit të bashkëpronarëve në origjinë. Kështu,

gjkata e shkallës së parë në vlerësim të provave të administruara në gjykim ka arritur në përfundimin se për krijimin e pasurisë (blerjen e truallit dhe ndërtimin e objektit), krahas bashkëshortëve M.J. dhe N.J. që paraqiten në aktet përkatëse, kanë kontribuar edhe dy fëmijët (djemtë) e tyre bashkë me bashkëshortet dhe se për këtë shkak edhe ata kanë fituar të drejta (bashkë)pronësie, ndërkohë që gjykata e apelit ka arritur në përfundimin e ndryshëm se nga ato prova nuk provohet që këta të fundit të kenë kontribuar në krijimin e pasurisë dhe që ata të kenë fituar të drejta (bashkë)pronësie për këtë shkak. Ndërkohë që Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkueseve, ka vlerësuar si haptazi të pabazuara pretendimet e ngritura nga ato në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykata e apelit.

21. Referuar standardeve kushtetuese të mësipërme, Kolegji vëren se argumentet e paraqitura nga kërkueset për të drejtat e pretenduara si të cenuara, atë për gjykim të drejtë dhe të pronës private, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe interpretimit e zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, të cilat, për sa u përket gjykatave të faktit, janë ndarë në qëndrimet e tyre qoftë në lidhje me të provuarin e kontributit në krijimin e pasurisë, ashtu dhe për interpretimin dhe zbatimin e ligjit për sa i përket fitimit të pronësisë përmes një mënyre të tillë. Megjithatë, gjykatat kanë arsyetuar qoftë në drejtim të fakteve që i kanë vlerësuar të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, përfshirë dhe për sa i përket pretendimit të kërkueseve për kontributin për krijimin e pasurisë, ashtu edhe në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit për sa i përket përcaktimit të rrethit të bashkëpronarëve dhe pjesëve të tyre takuese në pasurinë objekt pjesëtimi. Në këtë kontekst, Kolegji vëren se kërkueset nuk kanë arritur të argumentojnë se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme është arbitrar, në kuptimin që gabimi faktik ose ligjor i tyre të jetë aq i dukshëm sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkueseve për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të së drejtës së pronës private nuk mund të merren në shqyrtim.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.